



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TURIZMIT  
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES  
DREJTORIA E FINANCËS

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2015

**Drejtuar: MINISTRISË SË FINANCAVE**  
**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT**

**TIRANË**

**Lënda:** Monitorim vlerësimi i treguesve buxhetor për 9/mujorin 2015

Në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.160, datë 27.11.2014, “Per buxhetin e viti 2015”, Aktit Normativ Nr. 1 date 29.07.2015 “Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, Udhëzimit Nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit Plotësues Nr. 2, datë 09.01.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”, po paraqesim informacion mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe performancën e produkteve të realizuara për 9/mujorin e vitit 2015, për sistemin e MZHETTS-së.

Mbështetur në Aktin Normativ Nr. 1, datë 29.07.2015 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, me rishikimin e buxhetit për vitin 2015, në sistemin e MZHETTS përfshihet edhe Programi “Zhvillimi të Turizmit” me kod 04760, i cili përmbledh 3 Institucione buxhetore: Agjencinë Kombëtare të Turizmit, Zyrat e Shërbimit Turistik dhe Agjencinë Kombëtare të Bregdetit.

Njësitet strukturore të përfshira në kete program, kaluan në varësi administrative të MZHETTS , në bazë e zbatim të VKM Nr. 226, datë 25.02.2015 “Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve dhe fondeve buxhetore, për vitin 2015”.

Në total fonde buxhetore te menaxhuara në 4 programe, që përfshijnë 12 institucione buxhetore, janë 2,016,155 mijë lekë, të cilat sipas strukturës buxhetore paraqiten:

në 000/lekë

Struktura buxhetore	Plani 2015	Plani rishikuar 2015	Plani 9/mujor 2015	Realizimi 9/mujor 2015	Realizim 9 mujor ne %
Paga dhe Sigurimet	458,800	550,124	413,522	344,038	83%
Shpenzimetë tjera korrente	310.400	447,732	359,648	244,219	68%
Investime të brendshme	241, 000	268,348	246,659	113,124	46%
Financime të huaja	1,000,000	750,000	568,000	217,506	38%
<b>TOTALI MZHETTS</b>	<b>2,010,200</b>	<b>2,016,155</b>	<b>1,613,302</b>	<b>938,960</b>	<b>58%</b>

Më poshtë analizojmë faktorët që kanë ndikuar:

❖ **Shpenzimet e Personelit.** Realizimi i shpenzimeve të personelit, është bërë në bazë e zbatim të vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave, bazuar në strukturat dhe nivelin e pagave. Realizimi në masën 83% i këtij treguesi, ka ardhur për arsye të mosplotësimit të vendeve vakante në strukturat e institucioneve, dhe efektet e raporteve mjeksore, pagesat e të cilave kryhen nga Sigurimet Shoqërore.

❖ **Shpenzimet e tjera korrente,** janë realizuar rreth 68 % si rezultat:

- Shpenzimet operative të konsideruar si shpenzime bazë të funksionimit të veprimtarisë së ministrisë kanë qënë të qëndrueshme dhe nuk kanë ndryshime në strukturë shpërndarje, me vitin e kaluar. Realizimi i këtij treguesi ka qënë nën ndikimin e mospërfundimit të disa tenderave brënda kësaj periudhe, nga Ministria e Brendshme. Realizimi i shpenzimeve në këtë kategori është bërë sipas regjistrimit të parashikimit publik, me ndryshime të vogla të regjistrimit të prokurimeve, në varësi të nevojave të institucionit. Zhvendosja në ambjentet e reja të punës (Shtëpia e Ushtarakëve), për 3(tre) institucione QKR, QKL dhe DPPM, kufizoi deri diku realizimin e një pjesë të shpenzimeve të këtij grupimi. Shërbime nga të tretë, energji, uje, telefon, është grupi kryesor i shpenzimeve operative.
- Transferrat korente me jashtë janë realizuar vetëm për fatura të paraqitura, nga organizmat ndërkombëtar, ndaj të cilëve MZHETTS ka detyrime.

❖ **Duke analizuar realizimin e Investimeve të brendshme, rezulton se shpenzimet për investime** janë realizuar rreth 46 % ose 133 mln lekë, më pak se plani, vëmë në dukje:

-Për *Aparatin* nuk janë kryer pagesa, për detyrimin Kosto Lokale në vlerën 9 mln lekë, për projektin “Mbështetje për harmonizimin e të drejtës ekonomike dhe tregtare me normat e BE ...” si pasojë e mosdërgimit të faturave përkatëse .

- *Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve*, gjatë kësaj periudhe, janë rritur aplikimet si dhe disbursimet prej 7,9 mln lekë, që pritet të realizohen deri në fund viti, për projektet ‘Fondi i konkurrueshmërisë’, dhe “Bizneset e mbështetura me fondin Start – Up”. Agjencia e Nxitjes së Investimeve të Huaja (AIDA) po mendon të rishikojmë Fondin e Grave Sipërmarrëse, në mënyrë që ta bëjë atë më tërheqës për femrat në biznes. Ndonëse ky fond ka qënë aktiv, deri tani nuk ka pasur aplikime. AIDA po shikon mundësinë për ta lidhur edhe me institucionet bankare në mënyrë që të bëhet e mundur ulja e normës së interesit, duke qënë se është konsideruar disi e lartë.

Është vendosur një normë interesi limit që është 16%, ku 8% paguhen nga AIDA dhe 8% nga vetë sipërmarrja. Avantazhi në rastin e financimit nga institucionet e mikrokredisë është se nuk është e nevojshme që të vendoset kolateral, ndryshe nga bankat.

Janë në proces të përcaktimit të udhëzimeve për procedim të mëtejshëm në menaxhimin e Projektit “Trajnime për biznesin +TNA”, ashtu sikurse dhe disa projekte të tjera janë në procedura prokurimi.

Ndërsa për Projektin “Expo Milano 2015”, realizimi i fondit është në masën 94%.

-Për *Qendrën Kombëtare të Regjistrimit* , pjesa më e madhe e projekteve janë në proces realizimi, pasi janë lidhur kontratat me të treta, duke i çuar investimet e brendshme drejt realizimit. Është në procedurë hartimi i projektit “Për përmirësimin e sistemit të regjistrimit tregtar, bazuar në ligjin “Për ndarjen e Re Administrative”. *Është në proces*

prokurimi projektimi prevendimi dhe zbatimi i Rikonstruksionit të Godinës së Re të QKR dhe QKL, në ambjentete e ish –Shtëpisë së Ushtarakëve.

-Për Drejtorinë e Përgjithëshme të Metrologjisë, është në perfundim realizimi i projektit “ Blerje pajisje për laboratorin e volumeve rrjedhjeve dhe kimisë” Ndersa në faze tenderimi është investimi për projektin “Blerje pajisje laboratorit” me vlerë 17,4 mln leke. Një arsye tjetër, që ka ndikuar në këtë masë realizimi, në vlerë, i fondeve të planifikuara për investime publike, ka qënë dhe procedura e përqëndruar e prokurimit tek M.P.Br , si organi qëndror blerës.

❖ **Lidhur me Financimin e Huaj**, janë realizuar në masën 38 %, për arsye se:

- Projekti “Programi Italo-Shqiptar për Zhvillimin e Sektorit Privat në Shqipëri nëpërmjet një linje kredie për SME-të dhe sigurimin e Asistencës Teknike për to’, Prej fillimit të Programit janë lëvruar hua në dobi të 103 SME-ve Shqiptare me një pagesë të përgjithshme prej 22 milion Euro , mbështetur në Linjën e Kredise prej 25 milion Euro. Për periudhën Janar- Shtator 2015 janë disbursuar gjithsej në total 1,341,330 Euro. Deri më sot, kjo nismë është konsideruar një rast suksesi , sidomos duke patur parasysh mundësinë e përfitimit kredi për investime prodhuese, nga ana e bankave tregtare private pjesëmarrëse, gjatë një periudhe përgjithesisht shtrënguese në dhënien e huave. Kompanitë e financuara operojnë në sektorët e prodhimit, agropërpunimit, ndërtimit, përpunimit të drurit , këpuceve, teknologjisë së informacionit, etj.

-Projekti “Mbrotjtja e markave për produktet ndërkufitare” vazhdon të jetë në proces. Problematika e projektit për këtë vit është financimi i Kostos Lokale dhe vlerës së TVSH.

Më konkretisht po paraqesim realizimin e treguesve buxhetore, sipas strukturës, për secilin program.

#### 1. Program “ **Planifikim Menaxhim Administrim**”

në 000/ lekë

Struktura buxhetore	Plani i rishikuar 2015	Plani 9/mujori 2015	Realizimi 9/mujorin 2015	Realizimi në %
Paga dhe Sigurimet	155,800	120,550	93,598	<b>78%</b>
Shpenzime të tjera korrente	128,881	111,881	45,366	<b>40%</b>
Investime të brendshme	54,358	39,000	26,322	<b>67%</b>
Financime të huaja	90,000	70,500	-	-
<b>TOTALI</b>	<b>429,039</b>	<b>342,474</b>	<b>165,829</b>	<b>48%</b>

Ky Program ka realizuar objektivat, që synon politika e programit dhe qëllimi i saj, Konkretisht:

Janë rikonstruktuar ambjentet e Ministrisë, duke siguruar kushte me të mira pune dhe komoditet të nevojshëm.

U siguroa Rregjistri i monitorimit të Investimeve publike, nëpërmjet implementimit të Platformes RMIP.

Rishikimi i strukturës dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzor, përmes trajnimeve sipas standardeve , për tju pëgjigjur prioriteve dhe objektiveve në përputhje me programin .

## 2. Program “ Mbështetje për Zhvillim Ekonomik ”

në 000/ lekë

Struktura buxhetore	Plani i rishikuar 2015	Plani 9/mujori 2015	Realizimi 9/mujorin 2015	Realizimi në %
Paga dhe Sigurimet	112,300	80,660	78,670	97.5%
Shpenzime të tjera korrente	139,750	107,664	92,787	86 %
Investime të brendshme	159,356	155,355	73,789	47.5 %
Financime të huaja	650,000	490,000	211,785	43%
<b>TOTALI</b>	<b>1,061,356</b>	<b>833, 678</b>	<b>457,030</b>	<b>55%</b>

Duke qene se ky **Program** zë peshën me të madhe në Ministri, për nga madhesi e fondeve buxhetore, edhe përgjegjësia për të realizuar qëllimin dhe objektivat e Politikës së tij është vlerësuar nga njësitë zbatuese.

-Janë mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, nëpërmjet disbursimit nga Fondi i planifikuar i Konkurueshmërisë, me realizimin 100% të investimit, duke ndihmuar në rritjen e konkurueshmërisë së ekonomisë si në tregun brenda dhe atë rajonal. Është siguruar mbështetja për biznesin kreativ, për 9 shërbime Artizane, duke shkuar drejt realizimit të fondit, me aplikimet e reja .

- Në kuadër të luftës kundër evazionit fiskal ka një fluks të lartë të shtuar të punës, për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, Janë rritur regjistrimet, kryesisht të bizneseve të reja dhe të peregjistruar, shtuar 2 shërbime të reja në sistemin e brendshëm on line, përmirësuar sistemi kompjuterik, nëpërmjet modeleve të reja dhe i raportimeve duke ju përgjigjur kesaj situatë. Gjatë kësaj periudhe u siguroa sistemi i numerimit për Sportelet e QKR-së.

- Janë tejkualuar licencat e miratuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, duke sjellë një përmirësim të klimës së biznesit dhe zhvillim të qëndrueshëm të tij.

- U realizua me sukses Projekti “Expo Milano 2015”, deri aktualisht dhe po vazhdohet menaxhimi i Pavionit sipas kontratës.

-Në zërin Investime kapitale të huaja, ku përfshihet Projekti me financim të Qeverisë Italiane “Mbështetje për SME-t” kjo nismë është e konsideruar e sukseshme, nëpërmjet kreditimit me kushte lehtësuese të bizneseve, sidomos gjatë një periudhe përgjithësisht shtrënguese.

## 3. Program “Mbështetje për Mbikqyrjen e Tregut, Infrastrukturen e Cilesisë e Pronësi Industriale ”

në 000/ lekë

Struktura buxhetore	Plani i rishikuar 2015	Plani 9/mujori 2015	Realizimi 9/mujorin 2015	Realizimi në %
Paga dhe Sigurimet	172,100	128,510	109,888	85%
Shpenzime të tjera korrente	71,381	59,359	50,961	86%
Investime të brendshme	50,193	47,863	13,014	27%
Financime të huaja	10,000	7,500	5,722	76%
<b>TOTALI</b>	<b>303,674</b>	<b>262,761</b>	<b>199,113</b>	<b>76%</b>

Ky Program ka realizuar objektivat e identifikuar në politikën e tij, nëpërmjet mbështetjes dhe promovimit të përdorimit të standardeve europiane e ndërkombetare, mbështetjes së pronësisë industriale, dhe zhvillimit të tregtisë dhe konkurrencës së ndershme si vijon :

-Janë realizuar objektivat lidhur me adoptimin e standardeve shqiptare, duke promovuar përdorimin e atyre Europiane. Ka rritje të shitjes së Standardeve.

-Jane realizuar objektivat lidhur me mbrojtjen e markave, patentave dhe regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, nëpërmjet vlerësimit të aplikimeve, kërkesave për regjistrim për shpikje të depozituar, aplikimeve për ripërtëritje dhe ndryshimeve të kërkuar për marka dhe patenta.

- Janë kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, inspektimet e parashikuara në subjekte, për përdorimin e instrumentave matës dhe verifikimi i matësve në përdorim .

-Janë realizuar kalibrimet në fushën e masës, forcës, volumit, gjatësisë dhe ato në fushën elektrike.

#### 4. Programi “Mbështetje për Zhvillimin e Turizmit ”

në 000/ lekë

Struktura buxhetore	Plani i rishikuar 2015	Plani 9/mujori 2015	Realizimi 9/mujorin 2015	Realizimi në %
Paga dhe Sigurimet	109,924	83,803	61,882	74%
Shpenzime të tjera korrente	107,720	80,744	55,105	68%
Investime të brendshme	4,441	4,441	0	0%
Financime të huaja	0	0	0	0
<b>TOTALI</b>	<b>222,085</b>	<b>168,988</b>	<b>116,987</b>	<b>69%</b>

Institucionet që përfshihen në Programin “Mbështetje për Zhvillimin e Turizmit”, janë angazhuar në realizimin e objektivave, brënda fushës së përgjegjesisë shtetërore, kryesisht:

-Pastrimin, monitorimin dhe mbikqyrjen e Zonës Bregdetare, në sezonin veror, nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, pastrimin e Ishullit të Sazanit në përputhje me planin e vendosur për menaxhimin e tij, ku u angazhuan 300 punonjësit me kontrate të përkohshme pune, miratuar me VKM Nr.379, datë 7.05.2015, për periudhën 15 maj -15 Shtator 2015.

- Organizimi i veprimtarive turistike nga Agjencia Kombetare e Turizmit, nëpërmjet panairove, ekspozitave , materialeve promocionale dhe dokumentare, për promovimin dhe zhvillimin e Turizmit dhe Shqipërisë si “destinacion turistik” në Europë e më gjerë.

**Në kuadër të menaxhimit** me efektivitet të Aktiveve në pronësi dhe përdorim të njëjësive të sistemit të MZHETTS, janë ndjekur procedurat standarde lidhur me dokumentimin, (regjistrin e tyre), ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi.

Eshtë ndjekur dhe monitoruar parandalimi dhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura financiare, në kuadër të VKM nr.50, datë 05.02.2014, “ Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e planit të veprimit”, gjë e cila lehtësoi sistemin e ministrise, nga borxhet.

Në bashkëpunim me institucionet e varesisë dhe drejtorinë përkatëse të Ministrisë së Financave, u evidentuan detyrimet e mbetura të pashlyer, dhe u morën masat e duhura për kryerjen e pagesave, duke respektuar afatet, pas miratimit të fondit për shlyerjen e tyre.

Monitorohen vazhdimisht detyrimet e krijuara rishtazi dhe po punohet për të garantuar mundësinë e shlyerjes së tyre brenda vitit.

Gjithashtu përdorimi i Fondit të Vecantë në mënyrë të përqëndruar nga Ministria e Financave, ka rritur efektivitetin e përdorimit të tij, për sistemin e MZHETTS, 16% e fondit të miratuar është përdorur, deri aktualisht.

Bashkëlidhur pasqyrat përkatëse.

Duke falenderuar për bashkëpunimin.

**FREDERIK SEITI**

-----

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Konceptoi:** Vali Murashi, Specialiste Buxheti

**Konfirmoi:** Suzana Stefa, Drejtore Financës

